- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediave), Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë **bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

---

**Vula**

## **Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor* ]

### **1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT për Lot 1 “Evadim i mbetjeve urbane”.**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;
- b. Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;
- c. Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;
- ç Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;
- d. Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;
- dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në **Shqipëri përfshirë Muajin Dhjetor 2020**.

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

**2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

1. License të leshuar nga QKL, Kodi III.2.B, për “Grumbullim dhe transportim të mbetjeve urbane”e shoqëruar me akt miratim.
2. Leje mjedisore nga Ministria e Mjedisit kodin III.1.A e tipit C në lidhje me objektin e prokurimit e shoqëruar me akt miratim.

**2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

- a) Kopje të certifikuar/vërtetuara të bilanceve për vitet 2017, 2018 dhe 2019 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet.
- b) Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit nga momenti i zhvillimit të tenderit ku vlera mesatare e tyre të jetë në një vlerë prej fondit limit të lotit përkatës ose shumës së loteve që konkurron .

**Te tjera:**

**Kopje të Certifikates elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformën Qendrore të Faturave.**

**Kopje të Certifikates elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontrates së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që leshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes software-ike.**

**2.3 Për kapacitetin teknik:**

1. Shërbime të mëparshme të ngjashme duhet të jetë të paktën deri në 40% e vlerës së fondit limit/vlerës të pritshme të kontratës që prokurohet të loti, apo shumës së loteve për të cilat konkurron të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

- Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Te kete kontrate me Landfill te licensuar per depozitim e mbetjeve urbane.e cila duhet te jete aktive ne momentin e hapjes se ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 24 muaj pas hapjes se ofertave(sa kohezjatja e marrveshjes kuader)/ose/ Te kete leje për shesh te hedhjes se mbeturinave të miratuara nga autoritetet përkatëse.

3. Shoqeria duhet te paraqesë Certifikatat e cilësisë me poshtë:

a) Certifikatën e cilësisë ISO 9001-2015 (e vlefshme)/ose/ ekuivalent për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme). /ose/ ekuivalent për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

c) Certifikatën OHSAS 18001-2015, per Sistemin e menaxhimit te shendetit dhe të sigurisë në punë (e vlefshme)/ ose/ ISO 45001:2018. per Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

***Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.***

4. Te kete ne pronesi ose me qera, 2(dy) automjet teknologjike specifike per mbetjet urbane që do te transportohen te shoqeruar me dokumentacionin perkates te makines perkatesisht:

- Dokumenta qe verifikojne qe automjetet jane ne pronesi ose me qera:
- Aktet e pronesise se mjeteve, ose kontratat originale ose te noterizuara te marrjes me qira te mjetit,
- Lejet e qarkullimit
- Certifikata e kontrollit teknik
- Siguracioni I mjetit
- Taksat
- Foto te automjetit, ku do te shifet qarte targa e makines qe do te perdoren gjate zbatimit te kontrates, per te bere identifikimin vizual te tyre.

5. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje punesim jo me pak se 4 (kater) punonjesish per periudhen 6 muaj para hapjes se ofertave (Qershori 2020- Dhjetori 2020), duke paraqitur nje vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj dhe shlyerjen e te gjithe detyrimeve te sigurimeve shoqerore per keto punonjes per kete periudhe.

6..Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të pakten **3(tre) muajt e fundit**, për punonjësit si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Mjedisi ose 1 (Ekspert në fushën e Mjedisit) për të cilin duhet të paraqitet:

- kontratë pune e vlefshme
- diplomë,
- CV.

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

○ **CERTIFIKATAT E CILËSISË**

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

○ **PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT:**

Nese nje operator ekonomik konkuron ne me shume se 1 lot te kesaj procedure prokurimi atehere ai duhet te zoteroje kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional per te realizuar objektin e procedures se prokurimit, pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim ( si psh kontratat e ngjashme, xhiro., etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkuron.

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT për Lot 2**  
**“Evadim i mbetjeve te rrezikshme”.**

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv),
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

**Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.**

**Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 4.**

**Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.**

**Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:**

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*

b. *Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar, sipas Shtojcës 1/1;*

c. *Deklaratën mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 4/1;*

ç *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*

d. *Deklaratën mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6;*

*dh. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në **Shqipëri përfshirë Muajin Dhjetor 2020.***

2. Për të provuar përmbushjen e kapaciteteve të mëposhtme, Ofertuesi duhet të dorëzojë:

### **2.1. Për kapacitetin ligjor/profesional:**

1. Licence nga QKL ne lidhje me objektin qe prokurohet .
2. Operatori ekonomik duhet të disponojë Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), së bashku me Akt Miratimin përkatës, si dhe liçencë Profesionale Përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore*), që të përfshijnë mbetjet me kod 18 01 02, ku proçedura e asgjësimit të jetë me incenerim.
3. Operatori Ekonomik duhet të disponojë Leje mjedisore të tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) së bashku me akt Miratimin përkatës si dhe liçencën profesionale përkatëse të kategorisë III.2.B (*Për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme Spitalore*)

që te përfshijnë mbetje të rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03, ku procedura e asgjësimit të jetë Autoklavim.

## **2.2. Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:**

a) Kopje të çertifikuara/vërtetuara të bilanceve për vitet 2017, 2018 dhe 2019 të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet.

b) Vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit nga momenti i zhvillimit të tenderit ku vlera mesatare e tyre të jetë në një vlerë prej fondit limit të lotit perkates ose shumës së loteve që konkurron.

### **Te tjera:**

**Kopje të Certifikates elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave.**

**Kopje të Certifikates elektronike për Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontrates së lidhur me Shoqerine e Certifikuar për zgjidhjen software-ike në përdorim, për tatimpaguesit që leshojnë faturat nepermjet zgjidhjes software-ike.**

## **2.4 Për kapacitetin teknik:**

1. Shërbime të mëparshme të ngjashme duhet të jetë të paktën deri në 40% e vlerës së fondit limit/vlerës të pritshme të kontratës që prokurimet të lotit, apo shumës së loteve për të cilat konkurron të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi.

- Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një punësim jo më pak se 4 (kater) punonjësish për periudhën 6 muaj para hapjes së ofertave (Qershor 2020- Dhjetor 2020), duke paraqitur një vërtetim të leshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj dhe shlyerjen e të gjithë detyrimeve të sigurimeve shoqërore për këto punonjës për këtë periudhë.

3. Një dokument që vërteton se ka në stafin e tij personel të trajnuar për teknologjinë që përdoret për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore.

4. Për transportin e mbetjeve, operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë automjete të izoluar hermetikisht, lehtësisht të identifikueshëm gjatë transportit të mbetjeve me shenjën dalluese ndërkombëtare të rrezikut të mbetjes mjekësore në përputhje me pikat 8.8/c dhe shtojcën nr. 4 të VKM-së Nr. 798 datë 29.09.2010 dhe sipas përcaktimeve të bëra në Udhëzuesin kombëtar “*Administrimi i sigurtë i mbetjeve Spitalore*” seksioni 9.3.3 (automjetet /anijet e grumbullimit). Operatori duhet të paraqesë dokumentacionin për vërtetimin e pronësisë ose të marrjes me qera të mjetit .

- Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:



- Për automjetin në pronësi:*Aktin e pronësisë së mjetit, leje qarkullimi, akt - kolaudimi dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare, si dhe foto te mjeteve ku te duket qarte targa dhe sinjalistika perkatese.*
- Për automjetet që nuk janë në pronësi:*Kontratë qiraje të shoqëruar me aktin e pronësisë së qiradhënësit, ku afati i marrjes me qira të automjetit të jetë minimalisht me afatin e ekzekutimit objekt prokurimi, si dhe leje qarkullimi, akt-kolaudim dhe polica e sigurimit të detyrueshëm të mjeteve motorrike për automjetet së bashku me Akt - Miratimet Higjenosanitare.*

**5.**Operatori ekonomik duhet të paraqesë një kontratë të lidhur me një landfill te licensuar per depozitim e produktit final qe del nga asgjесimi/trajtimi, e cila duhet te jete aktive ne momentin e hapjes se ofertave dhe e vlefshme për minimalisht 24 muaj pas hapjes se ofertave(sa kohezjatja e marrvешjes kuader)/ose/ Te kete leje për shesh te hedhjes se mbeturinave të miratuara nga autoritetet përkatëse.

**6.**Dokument qe verteton se ka ne pronesi ose me qera impjant incenerimi dhe autoklavimi te evidentuar ne Leje Mjedisore. Per te provuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret duhet te paraqesin: Dokument qe provon pronesine apo disponimin me qira ne nje nga menytrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qiraje, fature blerje ose zhdoganimi).

**7.**Dokument qe verteton se OE disponon peshore te kalibruar, për të siguruar zbatimin e VKM Nr. 371 date 11.06.2014 “Per miratimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe te dokumentit te dorezimit te tyre”, vertetuar kjo me ne nje nga menytrat e parashikuara nga legjislacioni shqiptar (kontrate blerje ose qiraje, fature blerje ose zhdoganimi), dokument per kalibrimin e mjeteve peshuese te shoqerohet me akt kolaudimi nga autoritetet perkatese dhe foto të peshores.

**8.**Operatori ekonomik ofertues do te sjelle ne ambjentet e Autoritetit Kontraktor ne daten dhe oren e hapjes se tenderit nga nje moster te kontenitoreve sipas VKM-se 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore”, pikat 8/4 dhe 8/5 te kreut III, te certifikuar CE, shoqeruar me certifikaten perkatese.si me poshte:

-Kontenieret e vegjel per mbetjet e rrezikshme, kontenitor plastik, minimalisht 2 permase me kapacitet nga 3 L deri ne 7 litra, nga 1 moster per seicilen permase;

-Kontenieret e medhenj per mbetjet me potencial infektues dhe ato te pergjithshmet, kontenitor plastik ose kartoni shoqeruar me qese te verdhe me 1 perdorim, minimalisht 4 permase me kapacitet nga 30 L deri ne 70 litra nga 1 moster per seicilen permase.

***Mostrat e dorëzuara, duhet te jene te shoqëruara me listën e inventarizimit. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj te veçante ose nëse mostra/t nuk eshte/jane ne perputhje me specifikimet teknike, atëherë oferta do te quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do te s’kualifikohet.***

**Operatori Ekonomik duhet te paraqesë Certifikatat e cilësisësi me poshtë:**

**9.**Certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001-2015 (e vlefshme)/ose/ ekuivalent për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**10.**Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme). /ose/ ekuivalent për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

**11.**Certifikatën OHSAS 18001-2015, për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe të sigurisë në punë (e vlefshme)/ ose/ ISO 45001:2018. për Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë për ushtrim të aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

***Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.***

*(të plotësohet nga autoriteti kontraktor)*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

○ **CERTIFIKATAT E CILËSISË**

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave të që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

○ **PJESMARRJA NË MË SHUMË SE NJË LOT:**

Nese nje operator ekonomik konkuron ne me shume se 1 lot te kesaj procedure prokurimi atehere ai duhet te zoteroje kapacitetet teknike, ekonomike financiare dhe kualifikimin profesional per te realizuar objektin e procedures se prokurimit, pra te gjitha loteve se bashku. Ne kete kuptim edhe kriteret e vecanta per kualifikim ( si psh kontratat e ngjashme, xhiro., etj) duhet te plotesohen nga operatori ekonomik ne varesi te loteve qe ai konkuron.

**Shtojca 8**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

## SPECIFIKIMET TEKNIKE LOT 1

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Nr	Pershkrimi i sherbimit	Njesia	Sasia	Numri I diteve te sherbimit	Cmimi	Vlera pa tvsh
1	Pastrim dhe evadim I mbeturinave urbane dhe transport drejt Landfillit te Bushatit (40 km vatje –ardhje m3/dite )	m3	6	182		
2	Pastrim dhe disinfektim me klor dhe gelqere pluhur I vendgrumbullimit te mbeturinave	m 2	40	182		
3	Mirembajtje e kontenireve te grumbullimit te mbeturinave urbane .	Here/vit	12	12		
4	Tarife pagese per landfill	kg	750	182		
	<b>Vlera totale per Lot 1 pa tvsh</b>					<b>4 943 182</b>

### Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe transportit të mbetjeve të ngurta urbane konsiston në :

- Zbrazen e kontenierëve 1100 litër me makinën e përshtatshme teknologjike të përcaktuar.
- Mbledhjen dhe largimin e mbeturinave të hedhura përreth në një distancë me rreze prej 5 m nga çdo kontenier.
- Pastrim të sipërfaqes prej 40 m<sup>2</sup> te pikes se grumbullit te mbetjeve urbane.
- Klorifikimi i zonës së kontenierëve me klor dhe gelqere pluhur, sipas normativave.
- Rivendosja e kontenierëve të sistemuar në vendin e caktuar. Kontenierët duhet të vendosen drejt, në pozicion vertikal dhe në mënyrë estetike per mjedisin urban dhe me kapakë të mbyllur.
- Larja e kontenierëve me uje me presion dhe solucion lares sipas nje grafiku te miratuar jo me pak se nje here ne muaj.
- Mirembajtje dhe zevendesim i koshave sipas kerkeses.
- Transportin e mbeturinave në landfill.

- Mbledhja dhe transportimi i mbetjeve urbane , pas mbarimit të kontratës deri ne lidhje te nje kontrate te re me kosto vetjake.

- Për asnjë rast nuk do të lejohen kazanë të tejmbushur me mbeturina, të patransportuara dhe mbeturina të lëna në zonen përreth kontenierëve. Në të gjitha rastet kur evidentohen bllokime apo pengesa nga faktorë të jashtëm, kontraktuesi duhet të njoftojë menjëherë dhe të marrë masa për pastrimin e tyre jo më vonë se 1 orë nga orari i përfundimit të shërbimit, i përcaktuar në grafik. Në rast të kundërt përgjegjësia është e kontraktuesit dhe do të vendosen penalitete.

- Firma kontraktuese duhet te kryeje sherbimin cdo dy dite para ores 8.00 me mjete transporti te pershatshme me ngarkim fundor ose anesor me kapacitet 5/10 ton si me poshte:



## **KUJDES**

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

**Shtojca 8**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

**SPECIFIKIMET TEKNIKE LOT 2**

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Nr	Kodi	Pershkrimi I sherbimit	Njesia	Sasia ne muaj mesatarisht	Dite sherbimi	Cmimi	Vlera pa tvsh
1	<b>180101</b> <b>180102</b> <b>180103</b>	Evatim I mbeturinave te rrezikshme spitalore	kg	5,2 kg	365		
		<b>Vlera pa tvsh Lot 2</b>					<b>1 822 080</b>

**Specifikimet teknike te evadimit te mbetjeve te rrezikshme spitalore me kod 180102, 180103**

Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet te asgjesohen ne nje impjant me medoten e incenerimit qe eshte i licensuar nga Ministria e Mjedisit, per kryerjen e ketij sherbimi me leje mjedisore te standartizuar. Terheqja e mbetjeve do behet sipas nevojave te kushteve te Spitalit Rajonal Shkoder, ne zbatim te kushteve te percaktuara ne kontrate.

Operatori ekonomik duhet te instaloje frigorifer (ngrires) ne ambjentet e Spitalit Rajonal Shkoder per ruajtjen e mbetjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impjantin e asgjesimit, si dhe te sigurohet mire dezinfektimit te frigoriferit dhe ambjentit ku eshte instaluar (frigoriferet jane ne perdorim te spitalit deri ne perfundim te kontrates).

Mbetjet duhet te merren nga operatori ekonomik prane Spitalit Rajonal Shkoder me mjet te posacem te sipermarresit dhe nga punonjesit e sipermarresit me ambalazhimin perkates (konteniere te dedikuara) ne perputhje me standartet e OBSH per mbetjet e rrezikshme anatomike spitalore te ngurta dhe te lengshme duke respektuar sipas VKM 798, dt.29.09.2010, "Per administrimin e mbetjeve spitalore" (kontenieret jane ne perdorim te spitalit deri ne perfundim te kontrates).

Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve, peshorja e cila duhet te disponohet nga Operatori Ekonomik. (peshorja do te ofrohet nga operatori fitues dhe duhet te shoqerohet me akt kolaudimi nga autoritetet perkatese).

Qeset duhet te mbulohen nga firma dhe duhet te jene me nje perdorim. Te gjithë kontenieret qe perdoren nga spitali duhet te merren nga firma dhe te behet dezinfekimii tyre prej saj. Ambalazhi duhet te jete sipas percaktimeve te percaktuara ne VKM 798, dt.29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore", si dhe Udhezuesit Kombetar "Administrimi i Sigurte i Mbetjeve Spitalore"

**Shtojca 9**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I  
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
<b>Kontrata Nr.</b>	<b>Titulli i Kontratës</b>	<b>Përshkrim i shkurtër i kontratës</b>
<b>01</b>	_____	_____
<b>02</b>	_____	_____
<b>03</b>	_____	_____
<b>...</b>	_____	_____

**Shtojca 10**

*(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

Shërbimi që kërkohet: sipas shtojces 8, Lot 1 dhe Lot 2

Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga nënshkrimi i draftit marreveshjes kuader.

## Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Nr	Pershkrimi i shërbimit	Njesia	Sasia	Numri I diteve te shërbimit	Cmimi	Vlera pa tvsh
1	Pastrim dhe evadim I mbeturinave urbane dhe transport drejt Landfillit te Bushatit (40 km vatje –ardhje m3/dite )	m3	6	182		
2	Pastrim dhe disinfektim me klor dhe gelqere pluhur I vendgrumbullimit te mbeturinave	m 2	40	182		
3	Mirembajtje e kontenireve te grumbullimit te mbeturinave urbane	Here/vit	12	12		
4	Tarife pagese per landfill	kg	750	182		
	<b>Vlera totale per Lot 1 pa tvsh</b>					<b>4 943 182</b>

Nr	Kodi	Pershkrimi I shërbimit	Njesia	Sasia ne muaj mesatarisht	Dite shërbimi	Cmimi	Vlera pa tvsh
1	<b>180101 180102 180103</b>	Evatim I mbeturinave te rrezikshme spitalore	kg	5,2 kg	365		
		<b>Vlera pa tvsh Lot 2</b>					<b>1 822 000</b>

Detyrat:

Shpërndarja:

**\* Sasitë e pritshme te shënuara janë të përafërta, llogaritur për një periudhë 24 mujore (2 vite), dhe nuk janë në asnjë mënyrë detyruese për Autoritetin Kontraktor. Ato janë vendosur me qëllim vlerësimin e njëjtë të të gjitha ofertave të Operatorëve Ekonomikë.**

Afatet e ekzekutimit: Kryerja e shërbimit do te filloje menjehere pas nënshkrimit te kontrates/marreveshjes

Vendi i kryerjes së shërbimeve:Spitali Rajonal Shkoder



## Shtojca 12

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR<sup>3</sup>

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

---

---

---

---

---

---

---

---

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

---

<sup>3</sup> Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

### Shtojca 13

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

#### FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët  oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera \_\_\_\_\_  
*(me numra dhe fjalë)*

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [\_\_\_\_\_]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

[Titullari i autoritetit kontraktor]

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_

\* \* \*

Procedura e prokurimit: \_\_\_\_\_

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:  oferta ekonomikisht më e favorshme  çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj. \_\_\_\_\_

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____	_____
<i>Emri i plotë i shoqërisë</i>	<i>numri i NIPT-it</i>
2. _____	_____

*Emri i plotë i shoqërisë*

*numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

---

---

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

2. \_\_\_\_\_  
*Emri i plotë i shoqërisë* \_\_\_\_\_ *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera \_\_\_\_\_/Pikët totale të marra \_\_\_\_\_  
(me numra dhe fjalë)

Etj.\_\_\_\_

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda \_\_\_\_\_ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë \_\_\_\_\_

Ankesa: ka ose jo \_\_\_\_\_  
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë \_\_\_\_\_

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15.**

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME** **Shërbimet –Kërkesë për propozim**

### **Neni 1: Qëllimi**

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e shërbimeve të prokuruarra me anë të procedurës kërkesë për propozim.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### **Neni 2: Përkufizime**

- 2.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.2 “Çmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontraktore.
- 2.3 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.4 “Palë (t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.5 “Autoriteti Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen shërbimin. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.6 “Kontraktues” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.
- 2.7 “Shërbime” do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

- 2.8 “Termet e References” shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

### **Neni 3: Hartimi i Kontratës**

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.
